FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.34 | 2 prill | 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 243 datë 4.3.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit.....	1241
Ligj nr.10 244 datë 4.3.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".....	1244
Ligj nr.10 245 datë 4.3.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara".....	1249
Ligj nr.10 246 datë 4.3.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".....	1256
Ligj nr.10 247 datë 4.3.2010	Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.....	1261
Ligj nr.10 252 datë 11.3.2010	Për disa shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.....	1269
Vendim i Kuvendit nr.26, datë 25.3.2010	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit".....	1270
Dekret nr.6461 datë 12.03.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	1270

Dekret nr.6464 datë 16.3.2010 — Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1271

Dekret nr.6469 datë 18.3.2010 — Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare..... 1272

Dekret nr.6483 datë 25.3.2010 — Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare..... 1272

LIGJ
Nr.10 243, datë 4.3.2010

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN NDËRMJET SHTETEVE PALË NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR SIGURINË E INFORMACIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6472, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

MARRËVESHJE
NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT VERIOR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT

Palët në Traktatin e Atlantikut Verior, të nënshkruar në Uashington, më 4 prill 1949;

Duke riafirmuar që konsultimi, bashkëpunimi dhe planifikimi i efektshëm politik për mbrojtjen në arritjen e objektivave të Traktatit kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

Duke ditur që masat ndërmjet qeverive të palëve në Traktatin e Atlantikut Verior për mbrojtjen dhe garantimin reciprok të informacionit të klasifikuar që ato mund të shkëmbejnë janë të nevojshme;

Të vetëdijshme që kërkohet një kuadër i përgjithshëm për standardet dhe procedurat e sigurisë;

Duke vepruar në emër të tyre dhe në emër të organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët:

i) Mbrojnë dhe garantojnë:

a) informacionin e klasifikuar (shih aneksin I), të shënuar si të tillë, që vjen nga NATO (shih aneksi II) ose që i jepet NATO-s nga një shtet anëtar;

b) informacionin e klasifikuar, të shënuar si të tillë, të shteteve anëtare që i jepet një shteti tjetër në mbështetje të një programi, projekti apo kontrate të NATO-s.

ii) Ruajnë klasifikimin e sigurisë së informacionit sipas përcaktimit në (i) më sipër dhe bëjnë çdo përpjekje për ta garantuar atë përkatësisht.

iii) Nuk përdorin informacionin e klasifikuar sipas përcaktimit në (i) më sipër për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në Traktatin e Atlantikut Verior dhe vendimet dhe rezolutat që i përkasin atij Traktati.

iv) Nuk e deklarojnë këtë informacion sipas përcaktimit të (1) më sipër kundrejt palëve jo anëtare të NATO-s pa pëlqimin e dhënësit.

Neni 2

Në pajtim me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, palët sigurojnë ngritjen e një Autoriteti Kombëtar të Sigurisë për aktivitetet e NATO-s, që zbatojnë masat e sigurisë mbrojtëse. Palët vendosin dhe zbatojnë standarde të sigurisë që sigurojnë një shkallë të përbashkët të mbrojtjes për informacionin e klasifikuar.

Neni 3

1. Palët sigurojnë që të gjithë personat e shtetësisë së tyre përkatëse që, në ushtrim të detyrave të tyre zyrtare, kërkojnë ose mund të kenë akses në informacionin e klasifikuar KONFIDENCIAL dhe më lart të jenë autorizuar rregullisht para se ato t'i marrin këto detyra.

2. Procedurat e autorizimit të sigurisë synojnë të përcaktojnë nëse një individ, duke pasur parasysh besnikërinë dhe besueshmërinë e tij ose të saj, mund të ketë akses në informacionin e klasifikuar pa përbërë një rrezik për sigurinë.

3. Me kërkesë, secila nga palët bashkëpunon me palët e tjera në zbatimin e procedurave të tyre përkatëse të autorizimit për sigurinë.

Neni 4

Sekretari i përgjithshëm siguron që dispozitat përkatëse të kësaj marrëveshjeje zbatohen nga NATO (shih aneksin III).

Neni 5

Kjo marrëveshje në asnjë mënyrë nuk pengon palët në lidhjen e marrëveshjeve të tjera në lidhje me shkëmbimin e informacionit të klasifikuar që buron prej tyre dhe që nuk ndikon në objektin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

a) Kjo marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga palët e Traktatit të Atlantikut Verior dhe i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

b) Kjo marrëveshje hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit nga dy shtetet nënshkruese të instrumenteve të tyre të ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Ajo hyn në fuqi për çdo shtet nënshkrues tridhjetë ditë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

c) Kjo marrëveshje, në lidhje me palët ku ajo ka hyrë në fuqi, zëvendëson "Marrëveshjen e Sigurisë të Palëve në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior", aprovuar nga Këshilli i Atlantikut Verior në aneksin A (paragrafi 1) në shtojcën e bashkëngjitjes në D.C.2/7, më 19 prill 1952, dhe më vonë të përfshirë në bashkëngjitjen "a" (paragrafi 1) në C-M(55) 15 (finale), të aprovuar nga Këshilli i Atlantikut Verior, më 2 mars 1955.

Neni 7

Kjo marrëveshje mbetet e hapur për aderim nga çdo palë e re në Traktatin e Atlantikut Verior, në pajtim me procedurat e veta kushtetuese. Instrumenti i aderimit depozitohet te Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai hyn në fuqi, në lidhje me çdo shtet aderues, tridhjetë ditë pas ditës së depozitimit të instrumentit të aderimit.

Neni 8

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon qeveritë e palëve të tjera për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi apo aderimi.

Neni 9

Kjo marrëveshje mund të denoncohet me njoftim me shkrim nga çdo palë që i paraqitet depozituesit, i cili informon të gjitha palët e tjera për këtë njoftim. Ky denoncim hyn në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga depozituesi, por nuk ndikon mbi detyrimet tashmë të kontraktuara dhe të drejtat dhe kompetencat e përftuara më parë nga palët, në bazë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar për këtë qëllim nga qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Bruksel, më 6 mars 1997, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku secili tekst është njëlloj autentik, i cili depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga i cili kopje të vërtetuara u transmetohen nga kjo qeveri secilit prej nënshkruesve të tjerë.

Aneksi I

Ky aneks përbën një pjesë integrale të marrëveshjes.

Informacioni i klasifikuar i NATO-s përkufizohet si më poshtë:

a) informacion do të thotë njohuri që mund të komunikohet në një formë të caktuar;

b) informacion i klasifikuar është informacioni ose materiali i caktuar për të kërkuar mbrojtje ndaj deklarimit të paautorizuar që është caktuar si i tillë nga klasifikimi i sigurisë;

c) fjala “material” përfshin dokumente dhe çdo pjesë të instrumenteve apo pajisjeve apo armëve të prodhuara ose në proces prodhimi;

d) fjala “dokument” tregon çdo informacion të regjistruar, pavarësisht nga forma ose karakteristikat fizike, duke përfshirë pa kufizim, materialin e shkruar ose të shtypur, karta ose shirita për përpunimin e të dhënave, hartat, grafikët, fotografitë, pikturat, vizatimet, gdhendjet, skicat, shënimet ose letrat e punës, kopjet e karbonit, shiriti i bojës, ose riprodhimet me anë të çdo mjeti ose procesi, dhe regjistrimet e tingujve, zërit, magnetike ose elektronike apo optike ose video në çdo formë, dhe çdo pajisje portative ADP me mjete të brendshme kompjuterike për regjistrim, dhe mjetet e çmontueshme kompjuterike për regjistrim.

Aneksi II

Ky aneks përbën një pjesë integrale të marrëveshjes.

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi NATO do të thotë Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior dhe organet e rregulluara nga marrëveshja mbi statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, përfaqësuesit kombëtarë dhe personeli ndërkombëtar, të nënshkruar në Otavë, më 20 shtator 1951 ose nga protokolli mbi statusin e Selisë Ushtarake Ndërkombëtare, të ngritur në bazë të Traktatit të Atlantikut Verior, të nënshkruar në Paris, më 28 gusht 1952.

Aneksi III

Ky aneks përbën pjesë integrale të marrëveshjes.

Konsultimi kryhet me komandantët ushtarakë, me qëllim që të respektojnë prerogativat e tyre.

LIGJ
Nr.10 244, datë 4.3.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6473, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SLLOVAKE MBI MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

(Këtej e tutje të quajtura "Palët")

Duke njohur nevojën e caktimit të rregullave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që shkëmbehet brenda kuadrit të bashkëpunimit politik, ushtarak, ekonomik, ligjor, shkencor dhe teknologjik apo tjetër, si dhe të informacionit të klasifikuar që rrjedh gjatë procesit të një bashkëpunimi të tillë,

me synim mbrojtjen reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar që është klasifikuar në shtetin e një pale dhe transmetuar në shtetin e palës tjetër,

me dëshirën për të krijuar një komplet rregullash mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet shteteve të palëve,

duke konsideruar interesat reciprokë në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e shteteve të të dyja palëve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

a) ”Informacion i klasifikuar” është informacioni ose materiali, pavarësisht nga forma ose natyra e tij, që i nënshtrohet mbrojtjes ndaj manipulimit të paautorizuar dhe që është përcaktuar rregullisht nga klasifikimi i sigurisë, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të shteteve të palëve;

b) ”Autoritet kompetent për sigurinë” është organi i sigurisë kombëtare përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kësaj marrëveshjeje;

c) ”Palë e origjinës” është shteti i palës që transmeton informacion të klasifikuar në shtetin e palës tjetër;

d) ”Palë marrëse” është shteti i palës të cilit i dërgohet informacioni i klasifikuar nga shteti i palës tjetër;

e) ”Palë e tretë” është çdo shtet ose organizatë ndërkombëtare që nuk është palë në këtë marrëveshje;

f) ”Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë kontraktorësh që krijojnë dhe përcaktojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre që përmbajnë ose përfshijnë informacion të klasifikuar;

g) “Kontraktor” është një individ ose subjekt juridik që ka cilësinë ligjore për të përfunduar kontrata të klasifikuara;

h) ”Nevojë për të ditur” është parimi nëpërmjet të cilit aksesi në informacionin e klasifikuar lejohet për individët në lidhje me punën dhe detyrat e tyre zyrtare;

i) ”Certifikatë sigurie e personelit” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent i sigurisë një shtetasi të shtetit të palës për akses në informacion të klasifikuar, në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm;

j) ”Certifikatë sigurie strukture” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent i sigurisë që provon që një subjekt juridik ka zotësinë fizike dhe organizative për të përdorur dhe depozituar informacion të klasifikuar në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm.

Neni 2
Autoritetet kompetente të sigurisë

Autoritetet kompetente të sigurisë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

Për Republikën Sllovake:

Autoriteti i Sigurisë Kombëtare.

2. Shtetet e palëve informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për çdo modifikim në lidhje me autoritetet e tyre kompetente të sigurisë.

Neni 3
Klasifikimet e sigurisë dhe ekuivalentët

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë ekuivalentë dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm të shteteve të tyre përkatëse:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	REPUBLIKA SLLOVAKE	EKUIVALENTI NË ANGLISHT
TEPËR SEKRET	PRISNE TAJNE	TOP SECRET
SEKRET	TAJNE	SECRET
KONFIDENCIAL	DOVERNE	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	VYHRADENE	RESTRICTED

Neni 4
Parimet e sigurisë

1. Shtetet e palëve marrin të gjitha masat e duhura, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshme, për të mbrojtur informacionin e klasifikuar të përmendur në këtë marrëveshje. Këtij informacioni të klasifikuar i jepet e njëjta mbrojtje që i jepet informacionit të klasifikuar të brendshëm në nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë.

2. Palët shënojnë të gjithë informacionin e klasifikuar të transmetuar, prodhuar ose zhvilluar në pajtim me këtë marrëveshje, sipas nenit 3.

3. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës pritëse e ndryshon shënimin e klasifikimit të sigurisë ose e anulon atë vetëm kur kjo i kërkohet nga autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës.

4. Informacioni i klasifikuar i transmetuar përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ai është dhënë.

5. Aksesi në informacionin e klasifikuar kufizohet në individë mbi bazën e nevojës për të ditur që kanë certifikatën përkatëse të sigurisë së personelit, sipas legjislacionit të brendshëm dhe që janë instruktuar përkatësisht.

6. Pala marrëse nuk lejon akses në informacionin e klasifikuar sipas kësaj marrëveshjeje nga një palë e tretë pa aprovimin paraprak me shkrim nga pala e origjinës.

7. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standarde të krahasueshme të sigurisë, autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikat e tyre të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

8. Autoritetet kompetente të sigurisë informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet në legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës dhe, për të siguruar bashkëpunim të ngushtë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, ato mund të zhvillojnë konsultime me kërkesë të njërit prej tyre.

Neni 5
Ndihma në procedurat e verifikimit

1. Me kërkesë, autoritetet kompetente të sigurisë, duke marrë parasysh legjislacionin e brendshëm të shteteve të tyre, ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë procedurave të verifikimit të qytetarëve të tyre me banim ose strukturave që gjenden në territorin e shtetit të palës tjetër që paraprin lëshimin e certifikatave të sigurisë së personelit ose strukturave.

2. Palët njohin certifikatat e sigurisë së personelit dhe strukturave të lëshuara, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të shtetit të palës tjetër. Certifikatat e sigurisë janë ekuivalente, në pajtim me nenin 3.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë i komunikojnë njëra- tjetrës çdo informacion tjetër, në lidhje me ndryshimet në certifikatat e sigurisë së personelit dhe strukturave, veçanërisht në lidhje me rastet e tërheqjeve ose uljes së nivelit të klasifikimit të sigurisë.

Neni 6
Përkthimi, riprodhimi dhe asgjësimi

1. Informacioni i klasifikuar përkthehet dhe riprodhohet në pajtim me legjislacionin e brendshëm të palës marrëse.

2. Informacioni i klasifikuar i shënuar TEPËR SEKRET përkthehet ose riprodhohet vetëm me aprovim me shkrim të autoritetit kompetent të sigurisë së palës së origjinës.

3. Përkthimet kanë një shënim në gjuhën e përkthimit që tregon që ato përmbajnë informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

4. Përkthimi i informacionit të klasifikuar dhe informacioni i klasifikuar i riprodhuar vendoset nën të njëjtën mbrojtje, si dhe origjinali. Numri i kopjeve kufizohet në ata që kërkohet për qëllime zyrtare.

5. Informacioni i klasifikuar asgjësohet, në pajtim me legjislacionin e brendshëm, për të parandaluar rindërtimin e tij të pjesshëm ose të plotë.

6. Informacioni i klasifikuar i shënuar TEPËR SEKRET nuk asgjësohet; ai i kthehet autoritetit kompetent të sigurisë të palës së origjinës.

7. Autoritetit kompetent të sigurisë të palës së origjinës i jepet një kopje e raportit të asgjësimit të informacionit të klasifikuar.

Neni 7

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar normalisht transmetohet me rrugë diplomatike ose me rrugë të tjera të rëna paraprakisht dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

2. Pala marrëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

3. Palët mund të transmetojnë informacion të klasifikuar me mjete elektronike në pajtim me procedurat e sigurisë të rëna reciprokisht dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

4. Për dorëzimin e sendeve ose sasive të mëdha të informacionit të klasifikuar të rregulluar rast pas rasti, bihet dakord me shkrim, nga autoritetet kompetente të sigurisë.

Neni 8

Kontratat e klasifikuara

1. Para fillimit të bisedimeve parakontraktuale ndërmjet kontraktorëve të mundshëm me synim nënshkrimin e kontratave të klasifikuara, secili kontraktor informon autoritetin e tij kompetent të sigurisë, në lidhje me nivelin e klasifikimit të sigurisë të informacionit të klasifikuar përkatës.

2. Me kërkesë të një prej autoriteteve kompetente të sigurisë, autoriteti tjetër kompetent i sigurisë konfirmon me shkrim që kontraktorët e propozuar, si dhe individët që marrin pjesë në bisedimet parakontraktuale ose në zbatimin e kontratës së klasifikuar të kenë certifikatë të sigurisë së personelit ose strukturës të nivelit të përshtatshëm të klasifikimit të sigurisë.

3. Çdo kontratë e klasifikuar e përfunduar, në pajtim me këtë marrëveshje, përfshin:

a) Detyrimin e kontraktorit për të siguruar që ambientet e tij kanë kushtet e nevojshme për trajtimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar të nivelit të përshtatshëm të klasifikimit të sigurisë;

b) Detyrimin e kontraktorit për të siguruar që personat që përmbushin detyrat që kërkojnë akses në informacionin e klasifikuar të kenë certifikatën e përshtatshme të sigurisë së personelit;

c) Detyrimin e kontraktorit për të siguruar që të gjithë personat që kanë akses në informacionin e klasifikuar të jenë të informuar për përgjegjësinë e tyre kundrejt mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm;

d) Detyrimin e kontraktorit për të kryer inspektime periodike të sigurisë në ambientet e tij;

e) Listën e informacionit të klasifikuar dhe listën e fushave në të cilat mund të lindë informacioni i klasifikuar;

f) Procedurën e komunikimit të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë të informacionit të klasifikuar;

g) Mjetet e komunikimit për transmetimin;

h) Procedurën për transportin e informacionit të klasifikuar;

i) Individët ose subjektet juridike të përshtatshme dhe të autorizuara, përgjegjëse për bashkërendimin e ruajtjes së informacionit të klasifikuar në lidhje me kontratën e klasifikuar;

j) Detyrimin për të njoftuar çdo humbje, rrjedhje ose kompromet faktik ose të dyshuar të informacionit të klasifikuar;

k) Detyrimin e kontraktorit për të respektuar procedurat e trajtimit të informacionit të klasifikuar.

4. Çdo nënkontraktor duhet të përmbushë të njëjtat detyrime sigurie si kontraktori.

5. Një kopje e çdo kontrate të klasifikuar i jepet autoritetit kompetent të sigurisë të shtetit të palës ku kryhet puna, për të mundësuar mbikëqyrjen dhe kontrollin e përshtatshëm të sigurisë.

6. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente të sigurisë mund të vizitojnë njëri-tjetrin, me qëllim që të analizojnë efikasitetin e masave të zbatuara nga kontraktori për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të përfshirë në kontratën e klasifikuar. Njoftimi për vizitën bëhet të paktën njëzet ditë më parë.

Neni 9
Vizitat

1. Vizitat që përfshijnë aksesin në informacionin e klasifikuar nga shtetasit e shtetit të një pale në shtetin e palës tjetër i nënshtrohet aprovimit paraprak me shkrim nga autoriteti kompetent i sigurisë së palës pritëse.

2. Vizitat që përfshijnë aksesin në informacionin e klasifikuar lejohen nga shteti i një pale për vizitorët nga shteti i palës tjetër, vetëm nëse atyre:

a) u është dhënë certifikata e përshtatshme e sigurisë së personelit nga autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit kërkues;

b) u është dhënë autorizim për të marrë dhe pasur akses në informacionin e klasifikuar në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Vizitat që përfshijnë aksesin në informacionin e klasifikuar nga shtetasit e një shteti të tretë autorizohen vetëm nga një marrëveshje e përbashkët ndërmjet shteteve të palëve.

4. Autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit kërkues njofton autoritetin kompetent të sigurisë të shtetit pritës për vizitën e planifikuar nëpërmjet një kërkese për vizitë, që duhet të merret të paktën njëzet ditë para se vizita të ndodhë.

5. Në rastet urgjente, kërkesa për vizitë transmetohet të paktën shtatë ditë më parë.

6. Kërkesa për vizitë përfshin:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, vendin dhe datën e lindjes, shtetësinë, numrin e pasaportës ose të dokumentit të identifikimit;

b) emrin e subjektit juridik që përfaqëson vizitori ose të cilit i përket vizitorit;

c) emrin dhe adresën e subjektit juridik që duhet të vizitohet;

d) konfirmimin e certifikatës së sigurisë së personelit të vizitorit dhe vlefshmërinë e saj;

e) objektin dhe qëllimin e vizitës;

f) datën dhe kohëzgjatjen e pritshme të kërkesës së kërkuar, në rastin e vizitave periodike jepet periudha e plotë që mbulohet nga vizitat;

g) datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të autoritetit kompetent të sigurisë.

7. Me aprovimin e vizitës, autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit pritës i jep një kopje të kërkesës për vizitë subjektit ligjor që duhet të vizitohet.

8. Vlefshmëria e aprovimit të vizitës nuk është më shumë se një vit.

9. Shtetet e palëve mund të përpilojnë lista të individëve të autorizuar për të bërë vizita periodike. Listat janë të vlefshme për një periudhë fillestare prej dymbëdhjetë muajsh. Afatet e vizitave përkatëse rregullohen drejtpërdrejt me pikat e përshtatshme të kontaktit te subjekti juridik që duhet të vizitohet nga këta individë, në pajtim me kushtet dhe afatet e rëna dakord.

Neni 10
Shkelja dhe komprometimi i sigurisë

1. Në rastin e shkeljes ose komprometimit të sigurisë që rezulton në një komprometim faktik ose të dyshuar të informacionit të klasifikuar me origjinë ose të marrë nga shteti i palës tjetër ose të dyshimit që informacioni i klasifikuar është deklaruar te personat e paautorizuar, autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës ku shkelja ose komprometimi është realizuar informon autoritetin kompetent të sigurisë së shtetit të palës tjetër dhe kryen hetimin përkatës.

2. Nëse shkelja ose komprometimi i sigurisë ndodh në një palë të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë së palës së origjinës ndërmerr veprimet në pajtim me paragrafin 1.

3. Shteti i palës tjetër, me kërkesë, bashkëpunon në hetim.

4. Në çdo rast, shteti i palës tjetër informohet për rezultatet e hetimit dhe merr raportin final mbi shkaqet dhe masën e dëmit.

Neni 11
Shkaqet

Secila palë mbulon shpenzimet e veta që shkaktohen në lidhje me zbatimin dhe mbikëqyrjen e kësaj marrëveshjeje.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e masave të përshkruara në këtë marrëveshje, zgjidhet nëpërmjet bisedimeve të autoriteteve kompetente të sigurisë.

Neni 13
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje përfundohet për një afat të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të palëve me rrugë diplomatike, që konfirmon përmbushjen e procedurave të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo marrëveshje ndryshohet në çdo kohë mbi bazën e aprovimit reciprok me shkrim të palëve.

3. Secila palë, në çdo moment, mund ta prishë këtë marrëveshje me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, prishja hyn në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit përkatës.

4. Pavarësisht prishjes së kësaj marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar vazhdon të mbrohet, përveç kur pala e origjinës e liron palën marrëse nga ky detyrim.

Bërë në Tiranë, më 18.6.2009, në dy kopje origjinale, secila një në shqip, sllovakisht dhe anglisht, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast ndryshimi në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

LIGJ
Nr.10 245, datë 4.3.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6474, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË MBI MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë, (këtu quhen palët kontraktuese);

Duke rënë dakord për të zhvilluar bisedime për çështjet politike dhe të sigurisë dhe për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin e tyre reciprok;

Duke ditur ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për forcimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit të përbashkët;

Duke ditur që bashkëpunimi i mirë mund të krijojë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve kontraktuese;

Me synimin për të siguruar mbrojtjen reciproke të gjithë informacionit të klasifikuar, që është klasifikuar nga një palë kontraktuese dhe transferuar palës tjetër kontraktuese;

Me dëshirën për të vendosur rregulla mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, që do të shtrihet tek të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që do të përfundohet ndërmjet palëve kontraktuese dhe kontratat që do të jepen ndërmjet organizatave të palëve kontraktuese, që parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. ”Informacion i klasifikuar” është informacioni, dokumenti apo materiali i çdo lloji, pavarësisht nga forma e paraqitjes, mënyra dhe rrethanat e gjenerimit që kërkon mbrojtje nga hyrjet e paautorizuara për arsyet e interesit publik dhe që është klasifikuar nga një palë kontraktuese në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj të brendshme.

2. “Palë kontraktuese marrëse” është pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat, në të cilën transmetohet informacioni i klasifikuar.

3. “Palë kontraktuese e origjinës” është pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat, që nis informacionin e klasifikuar.

4. “Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje që përmban informacion të klasifikuar ndërmjet subjekteve të shteteve të palëve kontraktuese ose kontraktorëve të palëve kontraktuese, që krijon ose përkufizon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre.

5. “Organet kompetente të sigurisë” janë institucionet e shtetit të secilës palë kontraktuese të autorizuar dhe përgjegjëse për të siguruar mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të transferuar, marrë apo gjeneruar në kuadrin e aktiviteteve të përbashkëta të realizuara në kuadrin e kësaj marrëveshjeje në territorin e tyre në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme dhe për bashkërendimin e zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

6. “Kontraktor” është një person fizik ose juridik që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

7. “Vizitori” është një përfaqësues zyrtar i një prej palëve kontraktuese që duhet të vizitojë ambientet e palës tjetër kontraktuese, i përfshirë në aktivitete që kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar.

8. “Certifikatë sigurie personeli” është një vendim pas një procedure hetimore të kryer në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shtetit të një prej palëve kontraktuese, mbi bazën e të cilit një individ është i autorizuar të ketë të drejtën për të marrë dhe të trajtojë informacionin e klasifikuar deri në nivelin e përcaktuar në certifikatë.

9. “Certifikatë sigurie strukture” është një vendim pas një procedure hetimore që vërteton se një kontraktor, që nuk është një person fizik, është në gjendje të marrë, trajtojë dhe përpunojë informacion të klasifikuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shtetit të një prej palëve kontraktuese deri në nivelin e përcaktuar në certifikatë.

10. “Palë e tretë” është një organizatë ndërkombëtare, çdo subjekt shtetëror ose juridik që nuk është palë në këtë marrëveshje.

11. Parimi i “nevojës për njohje” është domosdoshmëria për të hyrë në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre specifike.

12. “Shkelja e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme që rezulton ose mund të rezultojë në hyrje të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

Neni 2
Zbatueshmëria

Kjo marrëveshje përfshin të gjitha aktivitetet në kuadrin e të cilave shkëmbehet informacion i klasifikuar ndërmjet palëve kontraktuese apo një personi fizik ose juridik nën juridiksionin e shteteve të tyre, me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre publike/zyrtare.

Neni 3
Klasifikimi i sigurisë

1. Shënimet e mëposhtme për klasifikimin e sigurisë së informacionit të klasifikuar në bazë të kësaj marrëveshjeje janë ekuivalentë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	REPUBLIKA E LETONISË	EKUIVALENTI NË ANGLISHT
TEPËR SEKRET	SEVISKI SLEPENI	TOP SECRET
SEKRET	SLEPENI	SECRET
KONFIDENCIAL	KONFIDENCIALI	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	DIENESTA VAJADZIBAM	RESTRICTED

Neni 4
Autoritetet kompetente të sigurisë

1. Autoritetet kompetente të sigurisë të palëve kontraktuese janë të mëposhtmet:
Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Drejtoria e Sigurimeve të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)
Këshilli i Ministrave
Blv. “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri
Për Qeverinë e Republikës së Letonisë:
Byroja e Mbrojtjes Kushtetuese
Miera street 85a
Riga, LV 1013
Letoni

2. Autoriteti kompetent i sigurisë i jep informacion autoritetit tjetër kompetent të sigurisë, në lidhje me organizimin e tij të sigurisë dhe rregullat procedurale, me qëllim që të lehtësohet krahasimi i vazhdueshëm dhe të ruhen standarde të krahasueshme të sigurisë.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë, lehtësojnë inspektimet e përbashkëta, me qëllim që të sigurohen që informacioni i klasifikuar i dhënë të mbrohet në mënyrën e mjaftueshme në shtetin e palës kontraktuese marrëse.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë informojnë menjëherë njëra-tjetrën, me shkrim, në lidhje me të gjitha ndryshimet në ligjet dhe rregulloret e brendshme të shteteve të tyre që ndikojnë mbi mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

5. Nëse është e nevojshme, autoritetet kompetente të sigurisë konsultohen më njëra-tjetrën mbi çështjet teknike mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe me masa reciproke, mund të hartojnë protokolle ekzekutive shtesë.

Neni 5

Parimet e sigurisë

1. Palët kontraktuese, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme të shteteve të tyre dhe në pajtim me këtë marrëveshje, marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur informacionin e klasifikuar të transferuar, të marrë ose të gjeneruar në kuadrin e aktiviteteve të përbashkëta të kryera në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët kontraktuese, në pajtim me nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, në lidhje me informacionin e klasifikuar të përkufizuar në paragrafin 1 të këtij neni, sigurojnë nivel të njëjtë mbrojtjeje si ai që sigurohet për informacionin e vet të klasifikuar.

3. Klasifikimi i sigurisë së informacionit të klasifikuar të marrë mund të ndryshohet me pëlqimin paraprak me shkrim të palës kontraktuese të origjinës.

4. Pala kontraktuese e origjinës informon palën kontraktuese marrëse, në lidhje me çdo ndryshim në shënimet e klasifikimit të sigurisë së informacionit të klasifikuar të transferuar.

5. Përveç shënimit të klasifikimit të sigurisë, periudha e vlefshmërisë për klasifikimin përcaktohet edhe në informacionin e klasifikuar të transferuar ose nëse kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së informacionit të klasifikuar në një dokument të veçantë. Gjithashtu mund të specifikohet edhe çdo udhëzim tjetër për trajtimin nga pala kontraktuese e origjinës, që kufizon përdorimin e informacionit të dhënë. Shënimet dhe udhëzimet e sipërpërmendura tregohen nga pala kontraktuese marrëse edhe në gjuhën e saj zyrtare.

6. Palët kontraktuese, me anë të autoriteteve të tyre kompetente të sigurisë, informojnë njëra-tjetrën në lidhje me udhëzimet e tjera të trajtimit të përmendura në paragrafin 5 të këtij neni, për çdo ndryshim të tyre dhe u përmbahet atyre.

7. Marrja e informacionit të klasifikuar të shënuar me KONFIDENCIAL / KONFIDENCIALI / CONFIDENTIAL dhe më sipër, dhe për vendndodhjet dhe pajisjet ku ky informacion i klasifikuar gjenerohet, përpunohet ose mbahet, është e kufizuar për individët që janë pajisur me një certifikatë të sigurisë së personelit të përshtatshme dhe të vlefshme dhe në këtë rast zbatohet parimi i nevojës për të ditur.

8. Mundësia për informacionin e klasifikuar të shënuar i KUFIZUAR/DIENESTA VAJADZIBAM/RESTRICTED kufizohet për individë, në rastin e të cilëve zbatohet parimi i nevojës për të ditur.

9. Informacioni i klasifikuar i marrë në bazë të kësaj marrëveshjeje mund të përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ai është dhënë. Informacioni i klasifikuar i gjeneruar në kuadrin e aktiviteteve të përbashkëta mund të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në marrëveshjen që është baza e atij aktiviteti.

Neni 6

Certifikatat e sigurisë

1. Palët kontraktuese njohin reciprokisht certifikatat e sigurisë së personelit të tyre dhe

certifikatat e sigurisë së strukturave të lëshuara në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shteteve të tyre. Ekuivalenca e certifikatave të sigurisë duhet të përcaktohet në pajtim me nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shteteve të palëve kontraktuese, ndihmojnë njëra-tjetrën me procedurat e verifikimit, me qëllim lëshimin e certifikatave të sigurisë së personelit dhe të certifikatave të sigurisë së strukturës.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë kanë të drejtë të përpunojnë të dhënat personale të përfshira në certifikatat e sigurisë së personelit në masën që është e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Të dhënat personale të marra mbrohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e shteteve të palëve kontraktuese.

Neni 7
Tregimi i informacionit të klasifikuar një pale të tretë

1. Informacioni i klasifikuar i marrë në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, mund t'i tregohet një pale të tretë vetëm me pëlqimin me shkrim të palës kontraktuese të origjinës. Kjo leje kërkohet nga autoritetet kompetente të sigurisë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen edhe për informacionin e klasifikuar të gjeneruar në kuadrin e aktiviteteve të përbashkëta, me kushtin që pëlqimi paraprak me shkrim i palës tjetër është i nevojshëm për tregimin.

Neni 8
Riprodhimi dhe përkthimi

1. Informacioni i klasifikuar i shënuar TEPËR SEKRET/SEVISKI SLEPENI/TOP SECRET mund të riprodhohet ose përkthehet me pëlqimin me shkrim të palës kontraktuese të origjinës duke treguar numrin maksimal të kopjeve.

2. Me përjashtim të informacionit të klasifikuar, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, numri i kopjeve të informacionit me shënime të tjera të klasifikimit të sigurisë mbetet i kufizuar për aq sa kërkohen për qëllime zyrtare.

3. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të palës kontraktuese të origjinës shënohen me të njëjtat shënime klasifikimi dhe mbrohen si origjinale.

4. Përkthimi i informacionit të klasifikuar bëhet vetëm nga persona që kanë një certifikatë sigurie të personelit të vlefshme dhe të nivelit të përshtatshëm. Informacioni i klasifikuar i përkthyer mban një shënim të klasifikimit të përshtatshëm të sigurisë dhe një shënim në gjuhën e përkthimit nga e cila bëhet e qartë se ajo përmban informacion të klasifikuar me origjinë nga shteti i palës tjetër kontraktuese.

Neni 9
Asgjësimi

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet në mënyrë që të parandalojë rindërtimin e plotë ose të pjesshëm.

2. Informacioni i klasifikuar i shënuar TEPËR SEKRET/SEVISKI SLEPENI/TOP SECRET nuk asgjësohet. Ai i kthehet autoritetit kompetent të sigurisë së origjinës.

3. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga autoritetet kompetente të sigurisë, subjektet e autorizuara të palës kontraktuese marrëse mund të shkatërrojnë informacionin e klasifikuar që nuk është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni me kalimin e periudhës së vlefshmërisë të përcaktuar nga pala kontraktuese e origjinës apo nëse nuk është më i nevojshëm. Për këtë informohet me shkrim autoriteti kompetent i sigurisë së origjinës.

Neni 10
Transferimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i shkëmbyer ndërmjet palëve kontraktuese në kuadrin e kësaj marrëveshjeje transferohet me anë të kanaleve diplomatike. Informacioni i klasifikuar mund të transmetohet edhe i kriptuar me anë të sistemeve kabllore ose jokabllore të transmetimit të të dhënave.

2. Mund të përdoren edhe mjete për transferimin e informacionit të klasifikuar, nëse kjo aprovohet paraprakisht nga autoritetet kompetente të sigurisë.

Neni 11
Vizitat

1. Vizitat në vendndodhjen e një prej palëve kontraktuese, ku trajtohet informacioni i klasifikuar apo kryhen programet ose kontratat e klasifikuara, lejohen për vizitorë nga shteti i palës tjetër kontraktuese, pasi të jetë marrë një leje me shkrim nga autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës kontraktuese që pret vizitorët. Kjo leje mund të lëshohet vetëm për personat që përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafët 7-8 të nenit 5.

2. Procedurat, në lidhje me vizitat, përcaktohen dhe miratohen ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shteteve të palëve kontraktuese.

3. Kërkesa me shkrim për vizitë përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat dhe qëllimin e vizitës; organizatat dhe mjetet që duhet të vizitohen;

b) mbiemrin dhe emrin e vizitorit, vendin dhe datën e lindjes së tij/saj, shtetësinë, numrin e pasaportës, ose një dokumenti tjetër të identitetit, emrin e punëdhënësit;

c) vërtetimi i certifikatës së sigurisë së personelit e nivelit të përshtatshëm për vizitorin i lëshuar nga autoriteti kompetent i sigurisë.

4. Palët kontraktuese garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të shteteve të tyre.

Neni 12
Kontratat dhe kontraktorët e klasifikuar

1.Nëse një palë kontraktuese, institucion shtetëror ose kontraktor kryen një kontratë të klasifikuar në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, autoriteti kompetent i sigurisë i kësaj pale tjetër kontraktuese merr përgjegjësi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të marrë në bazë të kontratës.

2.Para se njëra nga palët kontraktuese, t'ia tregojë informacionin e klasifikuar të marrë nga pala tjetër kontraktuese kontraktorit, autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës kontraktuese marrëse sigurohet që:

a) kontraktorët janë mbajtës të certifikatave të përshtatshme të sigurisë së strukturës;

b) të gjithë personat, detyra e të cilëve kërkon hyrjen në informacionin e klasifikuar të marrë, janë mbajtës të certifikatave të sigurisë së personelit të përshtatshme dhe janë trajnuar rregullisht në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Të gjitha kontratat e klasifikuara përmbajnë një listë të informacionit të klasifikuar me të dhëna të përshtatshme për identifikimin unik të informacionit të klasifikuar të transferuar në bazë të kontratës.

4. Autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit ku kryhet puna për kontratën e klasifikuar, mbikëqyr përputhjen e masave të sigurisë të zbatuara me ligjet dhe rregulloret e saj të brendshme.

5. Kontraktori ka të drejtë, me pëlqimin me shkrim të autoritetit kompetent të sigurisë të shtetit, të angazhojë nënkontraktorët në kontratën e klasifikuar. Nënkontraktori i mundshëm përmbush të njëjtat kërkesa sigurie si dhe kontraktori.

6. Autoritetet kompetente të sigurisë të palëve kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për të

gjithë kontraktorët dhe nënkontraktorët e angazhuar në kontratën e klasifikuar.

7. Palët kontraktuese mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, në lidhje me informacionin e klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet tyre.

Neni 13
Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e shkeljes së sigurisë ose kompromettimit të informacionit të klasifikuar, autoriteti kompetent i sigurisë i palës kontraktuese marrëse informon autoritetin tjetër kompetent të sigurisë të palës kontraktuese të origjinës për këtë pa vonesë dhe siguron hetim të përshtatshëm. Palët kontraktuese bashkëpunojnë në hetim.

2. Autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës kontraktuese të origjinës informohet në lidhje me masat e marra për të kufizuar dëmin e shkaktuar nga kompromettimi i informacionit të klasifikuar, përfundimin dhe rezultatet e hetimit, shkaqet e incidentit dhe masën e dëmit të shkaktuar.

Neni 14
Shpenzimet

Secila palë kontraktuese mbulon shpenzimet e veta të shkaktuara në kuadrin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje, zgjidhet me anë të konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë të palëve kontraktuese, në rast se nuk arrihet mirëkuptimi, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 16
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) pas marrjes së notës së fundit diplomatike, në të cilën palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të palëve kontraktuese. Këto amendime mund të propozohen me anë të kanaleve diplomatike me shkrim dhe hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

4. Kjo marrëveshje mund të prishet nga njëra prej palëve kontraktuese me anë të njoftimit me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese me anë të kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë kjo marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit për prishjen e saj.

5. Pas prishjes së kësaj marrëveshjeve, i gjithë informacioni i klasifikuar i dhënë në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, vazhdon të trajtohet dhe mbrohet në pajtim me këtë marrëveshje dhe i kthehet palës kontraktuese të origjinës.

6. Me prishjen e kësaj marrëveshjeje, informacioni i klasifikuar, që është marrë nga autoriteti kompetent i sigurisë, bazuar mbi masat e mëparshme me detyrimin e rikthimit, i rikthehet palës kontraktuese të origjinës.

Bërë në Tiranë, më 16.12.2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, letone dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.10 246, datë 4.3.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ÇEKISË PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6475, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE, MBI SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Çeke, këtu quhen "Palët",

me dëshirën për të siguruar mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet tyre ose ndërmjet subjekteve juridike dhe individëve nën juridiksionin e shteteve të tyre, duke respektuar reciprokisht interesat dhe sigurinë e tyre kombëtare, kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1
Objekti i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është sigurimi i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ose nxjerrë në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet palëve ose ndërmjet subjekteve juridike ose individëve nën juridiksionin e shteteve të tyre.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për çdo kontratë ose marrëveshje, si dhe për çdo bashkëpunim tjetër ndërmjet palëve ose ndërmjet subjekteve juridike ose individëve nën juridiksionin e shteteve të tyre që ka të bëjë me informacionin e klasifikuar.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

"Informacion i klasifikuar" është çdo informacion që, pavarësisht nga forma, kërkon mbrojtjen ndaj deklarimit të paautorizuar, përftimit të padrejtë ose humbjes, dhe është përcaktuar si i tillë në pajtim me legjislacionin vendas të shtetit të njërës palë.

"Kontratë e klasifikuar" është një kontratë që përmban ose ka të bëjë me aksesin në informacionin e klasifikuar.

"Pala e origjinës" është pala, duke përfshirë subjektet juridike dhe individët nën juridiksionin e shtetit të saj, që jep informacionin e klasifikuar.

"Pala marrëse" është pala, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e shtetit të tij, që merr informacionin e klasifikuar.

"Palë e tretë" është çdo shtet, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e tij, ose organizatë ndërkombëtare që nuk është palë në këtë marrëveshje.

Neni 3
Autoritetet kompetente për sigurinë

1. Autoritetet kompetente për sigurinë përgjegjëse për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

Në Republikën Çeke:

Nàrodni beypecnostni ùrad (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

2. Autoritetet e Sigurisë Kombëtare i japin njëra-tjetrës hollësi të tjera për kontaktet zyrtare.

Neni 4
Nivelet e klasifikimit të sigurisë

Barasvlershmëria e niveleve të klasifikimit të sigurisë është si më poshtë:

NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	NË REPUBLIKËN ÇEKE	TERMI I BARASVLERSHËM NË ANGLISHT
TEPËR SEKRET	PŘÍSNĚ TAJNÉ	TOP SECRET
SEKRET	TAJNÉ	SECRET
KONFIDENCIAL	DŮVĚRNÉ	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	VYHRAZENÉ	RESTRICTED

Neni 5
Aksesi në informacionin e klasifikuar

Aksesi në informacionin e klasifikuar, të dhënë në pajtim me këtë marrëveshje, kufizohet vetëm në individët rregullisht të autorizuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të shtetit të palës përkatëse.

Neni 6
Parimet e sigurisë

1. Pala e origjinës:

a) siguron që informacioni i klasifikuar të dallohet me shenjat përkatëse të klasifikimit të sigurisë, në pajtim me legjislacionin vendas të shtetit të saj;

b) informon palën marrëse për çdo kusht për nxjerrjen e informacionit të klasifikuar;

c) informon palën marrëse për çdo ndryshim të mëvonshëm në klasifikim ose deklasifikim.

2. Pala marrëse:

a) siguron që informacioni i klasifikuar të dallohet me nivelin e barasvlershëm të klasifikimit të sigurisë, në pajtim me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje;

b) siguron të njëjtën shkallë mbrojtjeje për informacionin e klasifikuar që i jepet informacionit të klasifikuar vendas me nivel të barasvlershëm të klasifikimit të sigurisë;

c) siguron që informacioni i klasifikuar të mos deklasifikohet dhe të mos ndryshojë klasifikimi, përveç kur autorizohet me shkrim nga pala e origjinës;

d) siguron që informacioni i klasifikuar të mos i jepet një pale të tretë pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të palës së origjinës;

e) përdor informacionin e klasifikuar vetëm për qëllimin që është dhënë dhe në pajtim me kërkesat e trajtimit të palës së origjinës.

Neni 7
Bashkëpunimi për sigurinë

1. Me qëllim që të ruhen standarde të krahasueshme për sigurinë, autoritetet kompetente për sigurinë, me kërkesë, informojnë njëra-tjetrën në lidhje me standardet e sigurisë kombëtare, procedurat dhe praktikat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

2. Autoritetet e sigurisë kombëtare, me kërkesë, në pajtim me legjislacionin vendas, ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë procedurave për certifikatën e sigurisë së personelit dhe certifikatën e sigurisë së strukturave.

3. Palët njohin certifikatat për sigurinë e personelit dhe certifikatat për sigurinë e strukturave, në pajtim me legjislacionin e brendshëm. Neni 4 i kësaj marrëveshjeje zbatohet përkatësisht.

4. Autoritetet kompetente për sigurinë njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën, në lidhje me ndryshimet në certifikatat e njohura për sigurinë e personelit dhe certifikatat e njohura për sigurinë e strukturave.

5. Bashkëpunimi në bazë të kësaj marrëveshjeje realizohet në gjuhën angleze.

Neni 8
Kontratat e klasifikuara

1. Autoritetet kompetente për sigurinë, me kërkesë, konfirmojnë që kontraktorët e propozuar, si dhe individët që marrin pjesë në bisedimet parakontraktuale ose në zbatimin e kontratave të klasifikuara të kenë certifikatë të përshtatshme sigurie për personelin ose certifikatë të përshtatshme sigurie për strukturën.

2. Autoritetet kompetente për sigurinë mund të kërkojnë që të kryhet një inspektim sigurie në një strukturë për të siguruar vazhdimin e përputhjes me legjislacionin e brendshëm, në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Kontratat e klasifikuara përmbajnë udhëzime sigurie programi mbi kërkesat e sigurisë dhe klasifikimit e çdo aspekti ose elementi të kontratës së klasifikuar. Një kopje e udhëzimeve të sigurisë së programit i transmetohet autoritetit kompetent për sigurinë të shtetit të palës nën juridiksionin e së cilës duhet të zbatohet kontrata e klasifikuar.

Neni 9
Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet në pajtim me legjislacionin e brendshëm të shtetit të palës së origjinës nëpërmjet kanaleve diplomatike ose ndryshe siç bihet dakord ndërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë.

2. Pala marrëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar të nivelit KONFIDENCIAL/DUVERNE/CONFIDENTIAL dhe më lart.

3. Palët mund të transmetojnë informacion të klasifikuar me mjete elektronike, në pajtim me procedurat e sigurisë, të aprovuara nga autoritetet kompetente për sigurinë.

Neni 10

Riprodhimi, përkthimi dhe asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Riprodhimet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar mbajnë shënime të përshtatshme për klasifikimin e sigurisë dhe mbrohen si informacion i klasifikuar origjinal. Numri i riprodhimeve kufizohet në numrin minimal të nevojshëm.

2. Përkthimet mbajnë një shënim në gjuhën e përkthimit, që tregon se ato përmbajnë informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

3. Informacioni i klasifikuar i shënuar si TEPËR SEKRET/PRISNE TAJNE/TOP SECRET përkthehet ose riprodhohet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4. Informacioni i klasifikuar i shënuar si TEPËR SEKRET/PRISNE TAJNE/ TOP SECRET nuk asgjësohet dhe i kthehet palës së origjinës.

5. Në rastin e një situate krize, që e bën të pamundur mbrojtjen dhe kthimin e informacionit të klasifikuar të nxjerrë ose dhënë në pajtim me këtë marrëveshje, informacioni i klasifikuar asgjësohet menjëherë. Autoriteti kompetent për sigurinë e palës marrëse njofton autoritetin kompetent për sigurinë e palës së origjinës, në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 11

Vizitat

1. Vizitat që kërkojnë akses në informacionin e klasifikuar marrin paraprakisht pëlqimin me shkrim të autoritetit kompetent për sigurinë, përveç kur është rënë dakord ndryshe nëpërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë.

2. Kërkesa për vizitë paraqitet nëpërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë të paktën njëzet ditë para vizitës. Në raste urgjente, kërkesa për vizitë mund të paraqitet në një afat më të shkurtër, pas bashkërendimit paraprak nëpërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë.

3. Kërkesa për vizitë përfshin:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e pasaportës-kartës së identitetit;

b) pozicionin e vizitorit dhe specifikimin e strukturës, që përfaqëson vizitori;

c) nivelin dhe vlefshmërinë e certifikatës së sigurisë së personelit të vizitorit;

d) datën dhe kohëzgjatjen e vizitës; në rastin e vizitave periodike përcaktohet periudha e përgjithshme e kohës që mbulohet nga vizitat;

e) qëllimin e vizitës, duke përfshirë nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar që përfshihet;

f) emrin, adresën, numrin e telefonit-faksit, adresën e postës elektronike dhe pikën e kontaktit të strukturës që duhet të vizitohet;

g) datën, firmën dhe vulën zyrtare të autoritetit kompetent për sigurinë.

4. Autoritetet kompetente për sigurinë mund të bien dakord për një listë vizitorësh që kanë të drejtën të bëjnë vizita periodike. Hollësi të mëtejshme për vizitat periodike janë objekt bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë.

5. Informacioni i klasifikuar i përftuar nga një vizitor konsiderohet të jetë informacion i klasifikuar i dhënë sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Shkelja e sigurisë

1. Palët informojnë menjëherë njëra-tjetrën me shkrim për çdo shkelje të vërtetuar ose të dyshuar të sigurisë që rezulton në shkelje, përftim të parregullt ose deklarim të paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

2. Autoritetet kompetente të palës pritëse e hetojnë incidentin pa vonesë. Autoritetet kompetente të palës së origjinës, sipas rastit, bashkëpunojnë në hetim.

3. Në çdo rast, autoriteti kompetent për sigurinë i palës pritëse informon autoritetin kompetent për sigurinë të palës së origjinës, me shkrim, në lidhje me rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e sigurisë, masën e dëmit, masat e marra për zbutjen e tij dhe rezultatin e hetimit.

Neni 13
Shpenzimet

Palët mbulojnë shpenzimet e tyre të shkaktuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 14
Interpretimi dhe mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, zgjidhet me bisedime ndërmjet palëve dhe nuk i paraqitet asnjë gjykate vendase ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje përfundohet për një periudhë kohe të pacaktuar. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit ndërmjet palëve, me rrugë diplomatike, që procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet mbi bazën e pëlqimit reciprok të palëve. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Secila nga palët ka të drejtë ta prishë këtë marrëveshje me shkrim në çdo kohë. Në një rast të tillë, vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje skadon pas gjashtë muajsh pas ditës në të cilën pala tjetër merr njoftimin me shkrim për prishjen.

4. Pavarësisht nga prishja e kësaj marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i dhënë ose nxjerrë në bazë të kësaj marrëveshjeje, mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të derisa pala e origjinës e liron palën marrëse nga ky detyrim.

5. Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e tjera të palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, e kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Pragë, më 19 nëntor 2009 në dy kopje origjinale, në shqip, çekisht dhe anglisht, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rastin e ndryshimit në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

LIGJ
Nr.10 247, datë 4.3.2010

PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (më tej KSHK), për zhvillimin, njohjen dhe dhënien e kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë, bazuar në standardet e njohurive, të shprehive dhe kompetencave, që duhet të arrijnë nxënësit/kursantët/studentët.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka objekt përcaktimin e strukturës, të objektivave, të funksioneve dhe të fushave, ku e shtrin juridiksionin e vet KSHK-ja, si dhe organizimin dhe drejtimin e KSHK-së, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, institucionet e ndryshme të pushtetit qendror apo vendor dhe me organizatat jofitimprurëse, që veprojnë për zhvillimin, ofrimin dhe përdorimin e kualifikimeve.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Aftësia" është zotësia për të zbatuar njohuritë dhe dijet, në përmbushjen e detyrave e në zgjidhjen e problemeve. Aftësia mund të jetë njohëse, kur vë në përdorim mendimin logjik, intuitiv dhe krijues, ose praktike, kur vë në përdorim shkathtësinë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave e instrumenteve.

b) "Akreditimi institucional" është procesi i njohjes së faktit, që institucionet e arsimit dhe të formimit përmbushin kriteret e duhura për cilësi, si dhe për programet e ofruara.

c) "Grumbullimi dhe transferimi i krediteve" është procesi i marrjes së krediteve për një kualifikim dhe njohja e këtyre krediteve nga një institucion a sistem tjetër.

ç) "Korniza europiane e kualifikimeve", në vijim (KEK), është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Europian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike e të tregut të punës, si dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës. Tetë nivelet e kualifikimeve përshkruhen nëpërmjet rezultateve mësimore, si njohuritë, aftësitë dhe kompetencat, që përshkojnë të gjitha format e kualifikimeve.

d) "Kompetenca" është zotësia e provuar në përdorimin e njohurive, të aftësive dhe të kapaciteteve personale, shoqërore dhe/ose metodologjike, në punë apo raste studimi, si dhe në zhvillimin profesional e individual. Kompetenca përfshin përgjegjësinë dhe autonominë e veprimit.

dh) “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, në vijim (KSHK), është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përftuar, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

e) “Krediti” është vlera numerike, që u jepet kualifikimeve ose përbërësve të kualifikimeve, të cilët përfaqësojnë vëllimin e të nxënit, të kërkuar për të arritur kualifikimin ose përbërësin e tij.

ë) “Kualifikimi” është specifikimi i standardeve në njohuri, aftësi dhe kompetenca të gjera, hartuar për të përmbushur një qëllim të caktuar, që i është njohur vlefshmëria ose është njohur zyrtarisht për këtë qëllim. Dhënia e kualifikimit për një individ nënkupton që njohuritë dhe aftësitë e këtij individi kanë vlerë në tregun e punës dhe në arsimimin e formimin e mëtejshëm të tij. Kualifikimi jepet, kur një organ kompetent përcakton, nëpërmjet një procesi vlerësimi të sigurisë së cilësisë, se individi i ka arritur standardet e specifikuara.

f) “Niveli”, elementi thelbësor i KSHK-së, është një paketë me 8 nivele reference, të cilat vlerësohen si një pikë e përbashkët dhe neutrale për autoritetet e arsimit dhe të formimit, në nivel kombëtar dhe sektorial.

g) “Njohuri” është gjithçka që arrihet, si rezultat i përvetësimit të informacionit, përmes të mësuarit. Njohuri do të thotë tërësia e fakteve, parimeve, teorive e praktikave, që lidhen me një fushë të caktuar të ushtrimit të profesionit apo të studimeve. Njohuria mund të jetë teorike dhe/ose faktike.

gj) “Standardet” janë formulimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të gjera, që duhen arritur nga nxënësit/kursantët/studentët, për të përmbushur një kualifikim.

h) “Të nxënit formal” është të nxënit që kryhet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar, të tilla si: institucionet e arsimit të lartë, shkollat, qendrat e formimit ose në punë dhe që është hartuar qartë si formë mësimore, në lidhje me objektivat, kohën dhe burimet. Të nxënit formal është i qëllimshëm dhe i planifikuar nga nxënësi, kursanti apo studenti. Përfundimi i këtij të nxëni certifikohet.

i) “Të nxënit joformal” është të nxënit, i përfshirë në veprimtari të planifikuara, jo domosdoshmërisht të hartuara si forma mësimore, në lidhje me objektivat, kohën mësimore ose mbështetjen mësimore, por që përmban elemente të rëndësishme mësimore. Të nxënit joformal është i qëllimshëm, i planifikuar nga nxënësit, kursantët apo studentët, i cili, në përgjithësi, nuk certifikohet, por, në raste të veçanta, mund të certifikohet.

j) “Të nxënit informal” është të nxënit, i cili përfitohet nga veprimtari të përditshme, që kanë lidhje me punën, familjen ose kohën e lirë. Ky lloj të nxëni nuk është i strukturuar dhe i organizuar për sa u përket objektivave, kohës apo mbështetjes mësimore. Në shumicën e rasteve, të nxënit informal është i paqëllimshëm, i paplanifikuar nga individi që nxë. Si rregull nuk certifikohet.

k) “Vlefshmëria” është procesi që siguron se standardet ose kualifikimet janë hartuar për të përmbushur nevojat e përcaktuara e të miratuara dhe janë të një cilësie teknike të përshtatshme.

KREU II
KORNIZA SHQIPTARE E KUALIFIKIMEVE (KSHK)

Neni 4
Objektivat e KSHK-së

Objektivat e KSHK-së janë:

a) të sigurojë se të gjitha kualifikimet e përfshira në këtë kornizë janë dhe mbeten të hartuara për qëllimin dhe përdorimin e tyre e se janë të cilësisë së kërkuar teknike;

b) të bëjë të qartë rëndësinë e kualifikimeve për punësimin dhe të mësuarit, duke përmbushur nevojat e nxënësve/studentëve/kursantëve, të ekonomisë dhe institucioneve të arsimit e të formimit, duke siguruar bazën për krahasimin e arritjeve me të gjitha pjesët e sistemit të arsimit dhe formimit kombëtar dhe ndërkombëtar;

c) të stimulojë zhvillimin e kualifikimeve, bazuar në standardet e krahasueshme ndërkombëtare të njohurive, aftësive dhe kompetencave më të gjera;

ç) të nxisë zhvillimin e të nxënit gjatë të gjithë jetës, përfshirë zhvillimin e vijueshëm të aftësive për të rriturit, duke siguruar mundësimin e kualifikimeve të nevojshme, për të garantuar përparimin;

d) të rrisë mundësitë e së drejtës për certifikim, të nxisë procese të ndryshueshme dhe të individualizuara të të mësuarit dhe të sigurojë rrugë të qarta e praktike, si baza për transferimin dhe përparimin;

dh) të përmirësojë mundësitë e punësimit dhe të të mësuarit për individët, duke ofruar bazat për njohjen e certifikimin për të mësuarit dhe arritjet e siguruara;

e) të ofrojë një instrument që mund të përdoret për të ndërmarrë nisma për përmirësimin e cilësisë dhe për të rritur domethënien e kualifikimeve.

Neni 5
Struktura e KSHK-së

1. KSHK-ja përmbledh të gjitha llojet dhe nivelet e kualifikimeve e të certifikimit, brenda një strukture prej tetë nivelesh, pasqyruar në shtojcat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij ligji.

2. Tetë nivelet përcaktohen nga rezultate tipike të të nxënit, të cilat gjenden në çdo nivel dhe nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me strukturën administrative të arsimit dhe të formimit ose me kohën e duhur për të arritur rezultatet.

3. Niveli më i ulët i KSHK-së është niveli 1 dhe niveli më i lartë është niveli 8. KSHK-ja identifikon edhe mënyrat e kriteret, të cilat lejojnë që individët të lëvizin nga një nivel në tjetrin, si horizontalisht, edhe vertikalisht, në të njëjtën kohë, që ata ndërmarrin studime të reja, për aftësi të reja.

4. Përparimi nga një nivel në tjetrin përcaktohet nga rezultatet mësimore, të cilat kërkojnë arritje në faktorët e gjendur në çdo nivel, si:

a) kompleksiteti e thellësia e njohurive dhe të të kuptuarit teorik e praktik;

b) përsosja e tërësisë së shprehive të praktikuara njohëse, krijuese dhe praktike;

c) shkalla e përgjegjësisë së pranuar dhe autonomia e treguar;

ç) natyra e lidhjeve me praktikën akademike, profesionale dhe të punës.

5. Struktura e KSHK-së lehtëson mbledhjen dhe transferimin e krediteve brenda secilit sektor të kornizës dhe në sektorët e tjerë. Sistemi i krediteve shqiptare të KSHK-së hartohet për të siguruar mundësinë e përdorimit dhe të marrjes pjesë në sistemet europiane të krediteve.

Neni 6
Fusha e zbatimit të KSHK-së

Fusha e zbatimit të KSHK-së përfshin:

a) kualifikimet e dhëna në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e sistemit të arsimit e të formimit, përfshirë arsimin e përgjithshëm parauniversitar, profesional dhe të lartë;

b) kualifikimet në të gjitha nivelet e të nxënit, nga ato që kërkohen për hyrjen në punë dhe pjesëmarrje në shoqëri, deri tek ato kualifikime të nevojshme, në nivelet më të larta akademike, si dhe në arsimin e formimin profesional;

c) certifikimet e rezultateve të të nxënit joformal dhe informal, në rastet kur ky i fundit certifikohet, përfshirë edhe njohjen e të nxënit të mëparshëm.

Neni 7
Funksionet e KSHK-së

1. Funksionet e domosdoshme për krijimin dhe mirëfunksionimin e KSHK-së janë:

a) akreditimi i institucioneve, të cilat ofrojnë programe, që çojnë drejt kualifikimeve të kornizës dhe vlerësojnë nxënësit/kursantët/studentët;

b) zhvillimi, mirëmbajtja dhe vlefshmëria e standardeve dhe kualifikimeve;

c) sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i nxënësve/kursantëve/studentëve;

ç) vlefshmëria e certifikimit të nxënësve/kursantëve/studentëve të suksesshëm;

d) menaxhimi i përgjithshëm dhe sigurimi i cilësisë së kornizës.

2. Funksionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohen nga institucionet zbatuese të arsimit të përgjithshëm, profesional dhe të lartë, të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji. Këto institucione veprojnë në përputhje me politikat dhe rregulloret e miratuara të KSHK-së.

KREU III
KËSHILLI I KSHK-SË DHE INSTITUCIONET ZBATUESE

Neni 8
Këshilli i KSHK-së

1. Për hartimin, miratimin e politikave dhe të rregulloreve të KSHK-së, për planifikimin dhe zbatimin e tyre krijohet këshilli i KSHK-së, më poshtë "këshilli", i cili, në ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave, mbështetet nga njësia e këshillit të KSHK-së.

2. Këshilli mblidhet të paktën katër herë në vit dhe kryen planifikimin, në nivel politikash, për zhvillimin e KSHK-së, monitoron zbatimin e tyre dhe raporton në Këshillin e Ministrave çdo gjashtë muaj.

3. Në funksionet e këshillit përfshihen:

a) përgjegjësia për planifikimin strategjik për hartimin dhe zbatimin e KSHK-së;

b) këshillimi për politikat, që lidhen me KSHK-në dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e funksioneve të saj dhe bashkërendimi i veprimtarive për zbatimin e tyre;

c) këshillimi i Këshillit të Ministrave për çështjet, që lidhen me KSHK-në.

4. Mënyra e ushtrimit të funksioneve dhe të kompetencave të këshillit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
Përbërja e këshillit të KSHK-së

1. Këshilli i KSHK-së kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe ka në përbërje:

a) një zëvendësministër të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

b) një zëvendësministër të Ekonomisë;

c) një përfaqësues të Konferencës së Rektorëve;

ç) një përfaqësues të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë;

d) dy përfaqësues të sindikatave, propozuar nga Këshilli Kombëtar i Punës.

2. Drejtorët e institucioneve zbatuese dhe zëvendësit e tyre marrin pjesë detyrimisht në mbledhjet e këshillit pa të drejtë vote. Anëtarët përfaqësues emërohen fillimisht në këshill për një mandat pesëvjeçar. Kryetari emëron si anëtarë individët e propozuar nga organet përkatëse.

Neni 10
Institucionet zbatuese

1. Institucionet zbatuese, të cilat kanë përgjegjësi të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së dhe të njohura nga këshilli, janë:

a) Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, për arsimin dhe formimin profesional;

b) Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit dhe Agjencia Qendrore për Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve, për arsimin e përgjithshëm (bazë e të mesëm);

c) Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit dhe institucionet e arsimit të lartë, për arsimin e lartë;

ç) Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

2. Institucionet zbatuese kanë për detyrë:

a) të kryejnë periodikisht shqyrtime vlerësuese të kualifikimeve dhe t'i krahasojnë ato me kualifikimet ndërkombëtare;

b) të këshillojnë institucionet përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, për çështje të krahasimit apo/dhe të ekuivalentimit;

c) të kryejë periodikisht vlerësime të tregut të punës.

Neni 11

Përbërja dhe detyrat e njësisë (sekretariatit) të këshillit të KSHK-së

1. Njësia (sekretariati) i këshillit të KSHK-së është njësi mbështetëse, e cila menaxhon detyrat administrative dhe organizative të këshillit.

2. Njësia (sekretariati) përbëhet nga 5 specialistë të fushave të arsimit, formimit, standardeve, vlerësimit dhe kualifikimeve, të cilët përzgjidhen nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik.

3. Funksionet dhe kompetencat e plota të njësisë (sekretariatit) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

SIGURIMI I CILËSISË NË KSHK

Neni 12

Kualifikimet në KSHK

1. Kriteret e përgjithshme dhe proceset specifike, sipas sektorëve, për miratimin e kualifikimeve, për përfshirje brenda KSHK-së, së bashku me përshkruesit përkatës, për çdo nivel të kornizës dhe kërkesat e përgjithshme për çdo lloj kualifikimi miratohen dhe publikohen nga këshilli, pas këshillimeve me subjektet e interesuara.

2. Kërkesat duhet të përputhen me praktikat më të mira ndërkombëtare, përfshirë përputhjen me nivelet, mjetet, kriteret dhe proceset e KEK-së, të Sistemit Europian të Krediteve, në AFP (SEKAFP), dhe Sistemit Europian për Akumulimin dhe Transferimin e Krediteve (SEATK).

Neni 13

Akreditimi institucional

1. Institucionet zbatuese sigurojnë që institucionet e arsimit dhe të formimit, të cilat ofrojnë programe, që të çojnë drejt kualifikimeve të KSHK-së, t'i ofrojnë këto programe në një nivel të pranueshëm cilësie dhe për të vlerësuar nxënësit/kursantët/studentët, sipas standardeve të kualifikimit.

2. Këshilli është institucioni, që zhvillon politikën për akreditimin institucional, e cila mund të përfshijë edhe akreditimin e programeve, për të orientuar punën e institucioneve zbatuese në këtë drejtim.

Neni 14

Vlerësimi dhe certifikimi

1. Këshilli miraton politikat për vlerësimin dhe certifikimin, duke përcaktuar parimet kryesore, në të cilat mbështeten institucionet zbatuese dhe organet e tjera, të përfshira në zbatimin e KSHK-së. Këshilli i propozon Këshillit të Ministrave rregulloret për dhënien e certifikatave, që lidhen me kualifikimet e KSHK-së.

2. Institucionet zbatuese:

a) pranojnë dhe regjistrojnë kandidatët për kualifikim;

b) sigurojnë vlerësime të të nxënit dhe të arritjeve të mëparshme;

c) vlerësojnë nxënësit/kursantët/studentët dhe arkivojnë dokumentacionin për vlerësimin e tyre;

ç) njohin kreditet e marra nga nxënësit/kursantët/studentët dhe mundësojnë transferimin e tyre;

d) zbatojnë sigurimin e cilësisë së vlerësimeve, që çojnë drejt kualifikimeve të miratuara, për të siguruar qëndrueshmëri në zbatimin e standardeve;

dh) marrin parasysh ankesat e nxënësve/kursantëve/studentëve për vendimet e kundërshtuara për vlerësimet;

e) japin certifikata kualifikimi dhe diploma;

ë) mirëmbajnë bazën e të dhënave dhe dokumentacionin vërtetues, për miratimin e kualifikimeve dhe për certifikatat e diplomat e dhëna.

3. Institucionet zbatuese dhe organizmat e tjerë, të përfshirë në zbatimin e KSHK-së, u sigurojnë mundësinë për vlerësim dhe certifikim të gjithë nxënësve/kursantëve/studentëve, që plotësojnë standardet e kërkuara, përfshirë edhe nxënësit/kursantët/studentët me aftësi të kufizuara.

KREU V
FINANCIMI

Neni 15
Burimet financiare

Nevojat financiare për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji mbulohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

1. Këshilli dhe njësia (sekretariati) krijohen brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve 8 pika 4, 11 pika 3 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6476, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

SHTOJCA 1: Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)

<table>
<tr><th></th><th>Arsimi i Përgjithshëm</th><th>Arsimi Profesional</th><th>Formimi Profesional</th><th></th></tr>
<tr><td>8</td><td>Doktoratë
(Diplomë universitare për gradë shkencore)</td><td>Programe studimi / Kualifikim për specialist ekspert (Diplomë universitare për specializime apo kualifikime post master)</td><td rowspan="5">Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përftimi ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë Profesionale).

Kurse për menaxherë, specialistë dhe teknikë të lartë sipas niveleve të “Arsimit Profesional” (Certifikatë Profesionale)</td><td>8</td></tr>
<tr><td>7</td><td>Programe studimi Master
(Diplomë universitare)</td><td>Programe studimi / Kualifikime e Specializime për menaxherë të lartë dhe për specialistë të lartë (Diplomë universitare profesionale për kualifikime apo specializime post Bachelor)</td><td>7</td></tr>
<tr><td>6</td><td>Programe studimi Bachelor
(Diplomë universitare)</td><td>Programe studimi profesionale Bachelor
Kualifikime për menaxherë dhe për specialistë (Diplomë universitare)</td><td>6</td></tr>
<tr><td>5</td><td>Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale)</td><td>Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm/Kualifikime për menaxherë të rinj dhe për teknikë të lartë deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale)</td><td>5</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Matura e përgjithshme (Diplomë e Maturës Shtetërore)
Programe studimi/Kurse kalimi (Dëftesë shkollore /certifikatë)
Programe studimi/Kurse afat-mesme (dëftesë shkollore 3)</td><td>Matura profesionale (Diplomë e Maturës Shtetërore)
Programe studimi/Kurse kalimi (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale)

Kualifikime për mbikëqyrës dhe për teknikë (Certifikatë)</td><td>Kurse kalimi (Certifikatë)
Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përftimi ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë kompetencash dhe
Certifikatë për mbikëqyrës dhe teknikë</td><td>4</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Programe studimi deri dy vjet në arsimin e mesëm/
Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 2)</td><td>Programe studimi/Trajnimi deri dy vjet për punëtor të kualifikuar
(Dëftesa shkollore / Certifikatë profesionale)</td><td>Kurse për punëtor të kualifikuar (Certifikatë për punëtor të kualifikuar)</td><td>3</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Programe studimi 1 vit në arsimin e mesëm /
Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 1)</td><td>Program studimi/trajnimi 1 vit, për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale)</td><td>Kurse Formimi/Trajnimi për ndihmës dhe punëtor gjysmë të kualifikuar (Certifikatë për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar)</td><td>2</td></tr>
<tr><td>1</td><td colspan="3">KUALIFIKIMET MINIMALE PËR HYRJE NË PUNË OSE JETË SHOQËRORE
(Dëftesë Lirimi)</td><td>1</td></tr>
</table>

SHTOJCA 2

	Njohuria	Aftësia	Kompetenca
Niveli 1	Njohuri bazë të përgjithshme	Aftësi bazë të nevojshme për kryerjen e detyrave të thjeshta	Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë brenda një kuadri të strukturuar
Niveli 2	Njohuri bazë faktike për një fushë pune ose studimi	Aftësi bazë njohëse dhe praktike për përdorimin e informacionit përkatës, me qëllim kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve rutinë, duke përdorur rregulla dhe mjete të thjeshta.	Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje, me pavarësi të caktuar
Niveli 3	Njohuri mbi faktet, parimet, proceset dhe konceptet e përgjithshme në një fushë pune ose studimi	Një sërë aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për përmbushjen e detyrave dhe për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet përzgjedhjes dhe për zbatimin e metodave, mjeteve, materialeve dhe informacionit bazë	Marrje e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave në punë e studim. Përshtatje në rrethana të caktuara për zgjidhjen e problemeve
Niveli 4	Njohuri teorike e faktike në një kontekst të gjerë në një fushe pune ose studimi	Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur probleme të veçanta në një fushë pune ose studimi	Vetëmenaxhim brenda kuadrit udhëzues të punës ose studimit, i cili zakonisht është i parashikuar, por mund të ndryshohet. Mbikëqyrje e punës rutinë të të tjerëve, duke marrë disa përgjegjësi për vlerësimin dhe përmirësimin e veprimtarive të punës ose studimit
Niveli 5	Njohuri gjithëpërfshirëse të specializuara faktike dhe teorike brenda një fushe pune apo studimi deri në një nivel të caktuar	Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet	Menaxhim dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive të punës ose studimit, në situata të ndryshueshme. Shqyrtimi dhe përmirësimi i performancës vetjake dhe të të tjerëve
Niveli 6	Njohuri të avancuara në një fushë pune apo studimi, duke përfshirë analizën kritike të teorive dhe parimeve	Aftësi të avancuara, që tregojnë mjeshtëri dhe inovacion, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë pune ose studimi	Menaxhim i veprimtarive ose projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke marrë përgjegjësi për vendimmarrje në një situatë të paparashikuar pune apo studimi. Marrje përgjegjësi për menaxhimin dhe zhvillimin profesional të individëve apo të grupeve
Niveli 7	Njohuri shumë të specializuara, disa prej të cilave në nivel të avancuar bashkëkohor në një fushë pune ose studimi, si bazë për mendim dhe kërkim origjinal. Analizë kritike e dijeve në një fushë ose në ndërveprimin e fushave të ndryshme	Aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve që nevojiten për kërkim dhe /ose inovacione, me qëllim që të zhvillojë njohuri dhe procedura të reja si dhe të integrojë njohuri nga fusha të ndryshme	Menaxhim dhe transformim i kontekseve të punës dhe studimit që janë komplekse, të paparashikueshme dhe që kërkojnë përqasje të reja strategjike. Marrje përgjegjësie për të kontribuar në njohuri ose praktikë profesionale dhe/ose për të rishikuar performancën strategjike të stafit/grupit.

Niveli 8	Njohuri në nivelin më të avancuar të një fushe pune apo studimi, si dhe në ndërveprimin ndërmjet fushave	Aftësi dhe teknika tepër të avancuara dhe të specializuara që përfshijnë sinteza dhe vlerësime të nevojshme për zgjidhjen e problemeve kritike në kërkim dhe/ose inovacion, si dhe zgjerimin dhe ripërcaktimin e njohurive ose praktikave profesionale ekzistuese	Të demonstrojë autoritet të plotë, inovacion, pavarësi, integritet studimor dhe profesional, përkushtim të vazhdueshëm për të zhvilluar ide dhe procese të reja në kontekstin më të avancuar të punës ose studimit, përfshirë dhe kërkimin

LIGJ
Nr.10 252, datë 11.3.2010

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005 "PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4, pas pikës 22 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje:
"23. "Viktimë e trafikimit", nënkupton personin fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës "e" të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"".

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
"4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.".

Neni 3

Në nenin 17 pika 1, pas paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
"Shërbimi Social Shtetëror administron shërbime shoqërore për individët në nivel kombëtar.".

Neni 4

Në nenin 38, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
"Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta parashikon në buxhetin e vet fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit, të cilat u

transferohen organeve të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime të përkujdesit shoqëror.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror do të përfitojnë financimin, vetëm nëse ato kanë një marrëveshje trepalëshe me Shërbimin Social Shtetëror dhe njësinë e qeverisjes vendore ku ofrojnë shërbimin. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe struktura pranë shërbimeve të përkujdesit shoqëror që do të mbikëqyrë administrimin.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6481, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

VENDIM
Nr.26, datë 25.3.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të neneve 20 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Fatbardh Kadilli caktohet anëtar i Komisionit për Politikën e Jashtme.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6461, datë 12.3.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetjë të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Nikoleta Stavri Buli-Tresa (Buli)
2. Zamir Naim Xhaxhe
3. Ilir Nuri Mehmetaj
4. Enea Ilir Mehmetaj
5. Aurora Hisni Mehmetaj (Paci)
6. Marjana Prel Fojleta (Sokoli)
7. Klodian Harilla Koçeli

8. Guxim Gani Gosturani
9. Nafije Ukë Brolowski (Dizdari)
10. Eduina Ali Beqiri
11. Jerina Ali Beqiri
12. Antoneta Hatem Blatz (Capunaj)
13. Nico Isak Hoda
14. Alma Kadri Sopi (Elezi)
15. Dhimitraq Irakli Naka
16. Orkida Taqi Dhima
17. Lulzime Fasli Kasapolli (Sala)
18. Genti Novrus Agalliu
19. Eni Sefedin Fëllanxa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6464, datë 16.3.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 14, 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Zeko Hilmi Murati (Sejko)
2. Artan Sami Murati
3. Ilir Sami Murati
4. Zhuli Harilla Bajram
5. Adis Avdi Shkreli
6. Nazime Kamber Daci
7. Ermir Skënder Doraci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6469, datë 18.3.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetjë të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Eliona Mustafa Xhani
2. Jon Elert Ajazaj
3. Festime Jahe Simoni (Jolla)
4. Ani Shyqyri Klosi
5. Deutschet Ndriçim Merdani
6. Zhuljeta Bajram Palla (Isa)
7. Xhoi Gjergji Palla
8. Alketa Nuredin Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6483, datë 25.3.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetjë të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fatbardha Medi Fejzollari (Muzho)
2. Kostaq Foto Roshi
3. Enias Thoma Vongo
4. Adrian Enver Werrel (Haxhiaj)
5. Manjola Skender Penker (Meta)
6. Leonard Fadil Malushaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 31.3.2010
Doli nga shtypi më 2.4.2010

Tirazhi: 3000 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë